



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 11, 12.2 shkronja d) ndërlidhur me paragrafët 2 dhe 3 të nenit 68 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenit 13 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr. 04/2018 për Transparency në Komuna, Udhëzimin Administrativ (MAPL) nr.06/2018 për Standaret Minimale të Konsultimit Publik në Komuna, nenit 61 parag. 1.8, të Statutit të Komunës, nr.01-020/01-0050862/18 të datës 29 qershor 2018, si dhe në pajtim me nenin 35 shkronja o), dhe 37 pika 4 të Rregullores së Komunës së Podujevës për mënyrat, procedurat dhe kushtet e pjesëmarrjes së qytetarëve në proceset e vendimmarrjes nr.01/18-02 të datës 31 janar 2011, si dhe në zbatim të Planit të Veprimit për Transparency për periudhën 2019 – 2023 në Komunën e Podujevës, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 08 maj 2019, miratoi,

VENDIM

PËR VËNIEN NË DISKUTIM PUBLIK TË PROPOZIM PROGRAMIN TREVJEÇAR TË BANIMIT 2019 – 2021

Neni 1

Vihet në diskutim publik Programi trevjeçar i banimit 2019 – 2021 i Komunës së Podujevës.

Neni 2

Diskutimi publik zgjat 30 ditë përkatësisht prej **13 maj 2019** deri më **10 qershor 2019**, dhe debati publik me qytetarë mbahet në sallën e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës më **29 maj 2019**, **në orën 11:00** në objektin e Komunës, salla e Kuvendit.

Neni 3

Propozimet, sugjerimet, apo vërejtjet eventuale paraqiten ditën e mbajtjes të debatit publik, gjithashtu në formë të shkruar mund të paraqiten gjatë kohëzgjatjes së diskutimit publik në Zyrën për Marrëdhënie me Publikun dhe Informim, ndërtesa e Komunës zyra nr.32, si dhe në formë elektronike mund të dërgohen në e-mail adresat; nazmi.elezi@rks-gov.net dhe bujar.gimolli@rks-gov.net të cilat pastaj i përcjellin në Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe tek Grupi punues për hartimin e Programit të veçantë të banimit.

Neni 4

Programi trevjeçar i banimit 2019 – 2021 publikohet në ueb-faqen zyrtare të Komunës
<http://kk.rks-gov.net/podujeve>

Neni 5

Diskutimin publik e zbaton Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale në bashkëpunim Grupin punues për hartimin e Programit të veçantë të banimit dhe në koordinim me Zyrën për Marrëdhënie me Publikun dhe Informim, të cilat obligohen të përgatitin raportin nga diskutimi publik dhe të japid sqarime për arsyeshmërinë e pranimit ose mospranimit të propozimeve dhe sugjerimeve konkrete.

Neni 6

Vendimi hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit ueb faqen zyrtare të Komunës.

Nr. 01-016/01-0037940/19
Podujevë, 08 maj 2019

Kryesuesi i Kuvendit
Farmir Gashi





KOMUNA E PODUJEVËS

PROGRAMI TREVJEÇAR I BANIMIT

2019-2021

Tetor 2018

LLOJI I DOKUMENTIT: PROGRAMI KOMUNAL PËR BANIM 2019-2021

ZYRA E KRYETARIT TE KOMUNËS

VENDIMI: 02-020/04-0034949/18 të datës 03.05.2018

GRUPI PUNUES - KOMISIONI PËR HARTIMIN E PROGRAMIT TREVJEÇAR PËR BANIM:

Nr.	Emri dhe Mbiemri	Drejtoria	Përgjegjësia në Komision
1	Doruntina Sollova	Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit	Kryesuese
2	Arbresha Bashota	Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenjës Sociale	Anëtare
3	Ismet Rama	Drejtoria për Pronë, Kadastër dhe Gjeodezi	Anëtar

Ky program është realizuar me ndihmën e projektit "Banimi për të gjithë" si pjesë projektit Promovimi i Shoqërisë Demokratike (DSP) – i financuar nga Agjencja Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe Ministria e Punëve të Jashtme e Danimarkës (DANIDA) dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF) implementuar nga OJQ Developing

Together. Përbajtja e këtij botimi është përgjegjësi e Developing Together dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet si qëndrim i SDC-së, DANIDA-së apo KCSF-së

Komisioni Komunal i angazhuar në realizimin e programit falenderon DT'në në ndihmën e dhënë.

PËRMBAJTJA	
HYRJE	4
QËLLIMI	5
VIZIONI DHE SYNIMET.....	5
OBJEKTIVI	6
SFIDAT.....	6
KORNIZA LIGJORE.....	7
PROFILI I KOMUNËS SË PODUJEVËS.....	8
POZITA GJEOGRAFIKE	8
TRASHËGIMIA NATYRORE DHE KULTURORE	12
KARAKTERISTIKAT DEMOGRAFIKE	15
AMBENTI BIZNESOR	25
KORNIZA E SHPENZIMEVE-POTENCIALI I KOMUNËS	25
BUXHETI	25
PLANIFIKIMI HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURA	26
ANALIZË E GJENDJES EKZISTUESE TË BANIMIT SOCIAL	27
OBJEKTTET KOMUNALE TË DEDIKUARA PËR BANIM SOCIAL	27
FAMILJET MOMENTALISHT TE NDIHMUARA ME BANIM SOCIAL	Error!
Bookmark not defined.	
KATEGORITË E SYNUARA.....	32
KRITERET PËR PËRCAKTIMIN E RADHËS SË PËRPARËSISË	33
KËRKESAT FAKTIKE PËR PËRKRAHJE	35
PLANIFIKIMI KONKRET PËR NDIHMË PËR BANIM SOCIAL	35
O1. SIGURIMI I BANIMIT PËR ____ FAMILJE	36
BANESAT E NDËRTUARA NGA KOMUNA, QEVERIA DHE DONATORËT TË CILAT JEPEN ME QIRA;	36
BONUS BANIMI	
BANESAT NË PRONËSI TË KOMUNËS, QË MUND TË ADAPTOHEN PËR BANIM SOCIAL	Error! Bookmark not defined.
BANIMI INDIVIDUAL	
PLANIFIKIMI BUXHETOR PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT	37
ANALIZA E FAKTEVE – PËRMBLEDHJE	38
INSTRUMENTET MBIKQYRËSE	41
TRANSPARENCA DHE PËRFSHIRJA E PUBLIKUT	41
O2 THEMELIMI I SEKTORIT TË BANIMIT	42
ÇËSHTJET E TJERA	43
SWOT ANALIZA.....	44
PËRFUNDIMI	45
BURIMI I TË DHËNAVE	46

HYRJE

Hartimi i Programit Trevjeçar i Banimit Social i referohet zgjidhjes së çështjes së banimit social në Komunën e Podujevës. E drejta për banim është nga të drejtat themelore të njeriut që garanatohet me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, me Kartën Evropiane të të Drejtave të Njeriut si dhe Konventën Ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut.

Banimi është një disiplinë mjaft komplekse që kërkon vëmendje nga autoritetet qëndrore dhe komunale. Në rastin konkret, me theks të veçantë kemi banimin social që nënkupton daljen në ndihmë familjeve në nevojë, pra atyre të cilët nuk janë në gjendje të bëjnë zgjedhjen e këtij problemi.

Ky program do të mundësojë kushte për banim të përshtatshëm dhe të qëndrueshëm për familjet të cilat nuk e kanë ende të zgjedhur çështjen e banimit ose jetojnë në kushte minimale të banimit. Komuna e Podujevës në programet e saj zhvillimore ka për qëllim përmirësimin e banimit social për banorët e saj.

Programi Trevjeçar i Banimit Social është punuar sipas metodologjisë përshkruese dhe interpretuese duke u bazuar në të dhëna konkrete të gjendjes ekzistuese. Fazat e hartimit të programit:

- Vendimi i Kryetarit për hartimin e Pogramit Komunal për Banim Social 2018-2020,
- Ngritja e komisionit i përbërë nga tre persona për hartimin e programit,
- Analiza e gjendjes, identifikimi i problemeve, Swot Analiza
- Planifikimi i zonave për ndërtim të objekteve për banim social, dhe
- Kriteret bazë për familjet që bëjnë kërkesë për të përfituar nga programet e veçantë të banimit.

Drejtoritë përgjegjëse për monitorimin dhe zbatimin e programit:

- Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëgenje Sociale
- Drejtoria për Buxhet dhe Financa
- Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit,
- Drejtoria për Shërbime Publike, Mbrojtje e Shpëtim
- Drejtoria për Pronë dhe Kadastër

QËLLIMI

Qëllimi i hartimit të Programit të Veçantë të Banimit në Komunën e Podujevës është adresimi i çështjeve të banimit brenda territorit të saj, pra të zhvilloj politika adekuate për zgjidhjen e nevojave për banim për grupe të caktuara të cilat nuk kanë mundësi ekonomike për të siguruar banim me çmime të tregut.

Qëllimi i hartimit të Programit të Veçantë të Banimit në Komunën e Podujevës është edhe që financimi/planifikimi i projekteve të bëhet mbi baza të ruajtjes së mjedisit.Kjo është e rregulluar edhe me Ligjin Nr. 03/L-214 i cili parandalon ose zvogëlon ndikimin negativ të projekteve të propozuara publike dhe private dhe në këtë mënyrë të kontribuoj në ruajtjen dhe përmirësimin e mjedisit, mbrojtjës së shëndetit dhe përmirësimin e cilësisë së jetës.

Financimi i programeve të veçanta të banimit është në përputhje me Ligjin

Nr.03/L-164, për Financimin e Programeve të Veçantës të Banimit dhe njëkohësisht, i nënshtrohet zbatimit të metodës së planifikimit strategjik që nënkupton dhënien e përgjigjës në pyetjet:

- Ku?
- Kur?
- Çka?
- Si të arrijmë atje?
- Përse?

VIZIONI DHE SYNIMET

Objektivat strategjike të mësipërme synojnë përmirësimin e cilësisë së jetës në komunë (rritjen e siguri, shtimin e mundësive për mënyrë aktive të jetesës, shtimin e sipërfaqeve të gjelbruara, përmirësimin i cilësisë së ajrit, etj.).

Komuna e Podujevës , vend që ofron mundësi për qytetarët që të gëzojnë të drejtat e tyre për një standard më të mirë të jetesës, me zotërim të sigurtë të pronës ,shërbime elementare ,banim të përshtatshëm, pjesëmarrje në qeverisje si dhe ofrimit të mundësive të barabarta për të gjithë.

Komuna e Podujevës synon tërheqjen e investimeve dhe përmirësimin e vazdueshëm të nivelit të jetesës në përgjithësi që rezulton në reduktimin e numrit të familjeve që kanë nevojë për mbështetje në fushën e banimit social.

PZhK-së parashev një zhvillim më miqësor me mjedisin, duke synuar pyllëzimin, ripyllëzimin, krijimin e disa shiritave të gjelbër, tampon zonave, parqeve dhe shume mundësi të rritjes se sipërfaqeve te gjelbra brenda vendbanimeve. Parashikohet krijimi i një mundësie qarkullimin me bicikleta përgjatë disa rrugëve e sidomos në disa vendbanime të mëdha.Një sfidë e veçantë mbetet zbatimi në praktikë i këtyre synimeve të PZhK-së; për pyllëzim, ripyllëzim, shirita të

gjelbër, tampon zona dhe në përgjithësi shtimin e hapësirave të gjelbra, krijimi i zonave rekreative dhe përmirësimi i treguesve mjedisorë të komunës.

Me hartimin e këtij programi synojmë që të plotësojmë obligimet ligjore duke respektuar Konventat Evropiane, Kartën Sociale Evropiane dhe Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut.

OBJEKTIVI

Komuna e Podujevës ka si objektiv që të krijoj kushte për banim të përshtatshëm dhe të qëndrueshëm në harmoni me standardet dhe normat evropiane të banimit, ashtu që të mundësoj zgjidhje të nevojave për banim për grupe të caktuara, të cilat grupe nuk kanë forcë ekonomikë që këtë problem ta zgjidhin sipas parimeve të tregut.

Objektivat strategjike të programit janë në përputhje me kushtet (parimet) e planifikimit hapësinor të qëndrueshëm. Objektivat:

- Komuna e Podujevës– Komunë që përballon nevojat për banim;
- Komuna e Podujevës– Komunë e shëndetshme
- Shtimi i sipërfaqeve pyjore dhe tjera të gjelbruara duke synuar rritjen e potencialit ekologjik dhe krijimin e korridoreve ekologjike të vendbanimeve;
- Përmirësim dhe zgjerim të rrugëve përfshire edhe korsi për bicikleta dhe këmbësorë;
- Përmirësim në transportin publik (përmirësim i shërbimit të autobusëve),
- Zgjerim i vendbanimeve në drejtimin e tokës më pak kualitative bujqësore.

SFIDAT

- Shkalla e lartë e papunësisë dhe varfërisë,
- Kosto e lartë e pajisjes me infrastrukturë adekuate (infrastrukturë jo e mjaftueshme)
- Kosto e lartë e banimit dhe kualiteti i ndërtimit jo adekuat
- Kapacitete jo të mjaftueshme komunale për zhvillimin e banimitsocial
- Mungesa e sektorit për banim, etj.

KORNIZA LIGJORE

Programi i prezantuar bazohet në legjislaturën në fuqi të Republikës së Kosovës. Ligjet dhe Udhëzimet administrative tek të cilat bazohet Programi Tre-Vjeçar për Banim i komunës së Podujevës është si në vijim:

- Ligji për Financimin e Programeve të Veçanta të Banimit Nr.03/L-164
 - Ligji për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore, Nr.04/L-061
 - Ligji për ndërtesat e banimit në bashkëpronësi, Nr. 04/L-1342013
 - Ligji për Vetëqeverisjen Lokale, Nr.03/L-40
 - Ligji për ndërtim,Nr. 04/L-110
 - Ligji për trajtimin e ndërtimeve pa leje, Nr.04/L-188
 - Ligji për Inspektoratin e produkteve të ndërtimit,2006/02-L62
 - Ligji për Procedurat Administrative, 2005/02-L28
-
- Udhëzuesi për hartimin e programeve të veçanta përbanim
 - Statuti i Komunës
 - Udhëzimi Administrativ për Procedurat për shpalljen e programeve të veçanta të banimit;
 - Udhëzimi Administrativ për Procedurat për përfitimin nga programet e veçanta të banimit;
 - Udhëzimi Administrativ për Normat minimale të banimit
 - Udhëzimi Administrativ për Përbajtjen e bonusit tëbanimit;
 - Udhëzimi Administrativ për Kriteret e përcaktimit të radhës së përparësisë për kategoritë e familjeve që mund të përfitojnë nga programet;

PROFILI I KOMUNËS SË PODUJEVËS

POZITA GJEOGRAFIKE

Komuna e Podujevës ka pozitë të mirë gjeografike, shtrihet në pjesën veri-lindore të Republikës së Kosovës. Ka rreth 88,499 banorë me një sipërfaqe prej 63,259.97 ha.

Komuna e Podujevës si tërësi ndahet në tri pjesë:

- **Zona Qendrore**
- **Zona Veri-perëndimore**
- **Zona Lindore**




Fig.1 Komuna e Podujevës

Komuna e Podujevës posedon një qendër kryesore administrative dhe tri qendra sekondare.




Fig.2 Qendra administrative kryesore dhe ato sekondare të Komunës së Podujevës

Në kufirin kadastral Komuna e Podujevës Kufizohet me:

- Në jug me Komunën e Prishtinës (në gjatësi prej 37.39 km),
- Në perëndim me Komunën e Obiliqit, Vushtrisë, Mitrovicës dhe Lepostaviqit (në gjatësi prej 46.92 km),
- Në veri-lindje me Republikën e Serbisë (në gjatësi prej 90.90 km).

Lartësia mbidetare e kufirit në pjesën perëndimore është mjaft e lartë ngase shtrihen në pjesën jugore të maleve të Kopaonikut. Në kufirin me komunën e Leposaviqit në majën Shatorica lartësia mbidetare është 1770 m. Pika më e ulët e kufirit është në pjesën jugore në fshatin Lupç i Poshtëm në luginën e lumit Llap me rrith 550 m. Duke u bazuar në burime të shumta historike, treva e Llapit është heret e banuar sepse ka kushte të volitshme natyrore.

Përbëhet nga 78 vendbanime (zona kadastrale) të cilat ndërlidhen nëpërmjet trafikut shtetëror, kjo ndërlidhje bëhet nëpër mes rrugëve:

M25	Magjistralja Podujevë-Prishtinë
R-125	Luzhan-Batllavë - Bërvénik/Kufiri me Serbinë
R-126	Batllavë-Podujevë - Reçicë
R-127	Lapashticë e Poshtme-Podujevë - Përpellac/Kufiri me Serbinë
R-128	Podujevë - Maxhunaj (Lidhje e papërfunduar)
R-129	Mitrovicë - Bajqinë

Tabela 1. Rrugët ndërlidhëse të Komunës së Podujevës




Fig.3 Harta e organizimit administrativ dhe rrugor

TRASHËGIMIA NATYRORE DHE KULTURORE

Karakteristikë e veçantë e Podujevës është edhe pasuria e vlerave të mëdha trashëgimore-kulturore. Sipas të dhënave dhe zbulimeve historike e arkeologjike, komuna e Podujevës, pjesë e Dardanisë antike, është tejet e pasur me vlera materiale autoktone. Zbulime arkeologjike janë gjetur në shumë vendbanime.

1	Lokaliteti arkeologjik "Vrlab" shek.XIII-XIV, nr.V.E.K.02-475/58	Bellasicë (I - 20)	1958
2	Lokaliteti arkeologjik "Poljanice" shek.III-VI, nr.V.E.K.0301-607/85	Gllamnik (III - 7)	1985
3	Lokaliteti arkeologjik "Qyteza" shek.IV p.e.sonë dhe shek.VI të Erës sonë, nr.V.E.K.0301-78/86	Lupç Poshtëm (I - 26)	i
4	Lokaliteti arkeologjik "Gumurishtë" shek.IV-V, nr.V.E.K.0301-80/86	Surkish (III - 8)	
5	Lokaliteti arkeologjik "Kalaja" shek.V-XIV, nr.V.E.K.0301-81/86	Ballovc (I - 28)	

Tabela 2. Monumente arkeologjike

6	Mbeturinat e varreve të vjetra, vendi i kishës dhe lisi shekullor shek.XIV, nr.V.E.K.02-596/65	Pollatë (I - 21)	1965
---	---	---------------------	------

Tabela 3. Varreza

7	Kisha e vjetër e braktisur e Shën Arkangjel Mëhillit (të verës) shek.XV, nr.V.E.K.02-1008/67	Rakinicë (I - 24)	1967
8	Mbeturinat e kishës së zonjës së bekuar-Zonja e Brainës shek.XIV, nr.V.E.K.524/66	Brainë (I - 22)	1966
9	Mbeturinat e kishës "Perandori Konstantin dhe Perandoresha Jelenë" me varr shek.XIV, nr.V.E.K.978/66	Orllan (I - 23)	
10	Mbeturinat e kishës së Marisë së zjarrtë shek.XVII, nr.V.E.K.0301-77/86	Batllavë (I - 25)	1986
11	Mbeturinat e them. të kishës së Shën Arkangjelit shek.XIV, nr.V.E.K.0301-79/86	Bradash (I - 27)	

Tabela 4. Monumete te besimit ortodoks dhe katolik

Vlerat e trashgëmisë natyrore në Komunën e Podujevës:

- Burimi i ujit në Revuç 1ha 16 ari e 94m viti i shpalljes 1988 Kategoria e III IUCN është i shpallur Monument natyror me karakter hidrologjik
- Burimi i ujit mineral në Sallabaj 31 ari e 47m viti i shpalljes 1988 Kategoria e III IUCN është i shpallur Monument natyror me karakter hidrologjik
- Burimi i ujit në Shakovicë 1ha 40 ari e 54m viti i shpalljes 1988 Kategoria e III IUCN është i shpallur Monument natyror me karakter hidrologjik
- Trungu i qarrit në Dumnicë të poshtme i shpallur me 1988 Monument natyror me karakter Botanik
- Trungu i qarrit në Pollatë i shpallur me 1988 ,monument natyror me karakter Botanik
- Trungu i Plepit në Orllan i shpallur me 1988 , Ish monument natyror me karakter Botanik (Tani ne shkatërrim e sipër)
- Trungu i qarrit në Dobratin i shpallur me 1988, monument natyror me karakter Botanik

Për shkak të vlerave të larta natyrore të tërsisë së Liqenit të Batllavës por edhe rëndësia e shfrytëzimit të ujit të pijshëm (në katër komuna të Republikës së Kosovës) , këtë vend e begaton edhe Kulla e Zahir Pajazitit në Turiçicë kështu që këto deomos duhet të hyjnë në mbrojtjen e monumenteve të rëndësisë së veçantë. Gjatë sezonit veror ky liqen tërheq mijëra vizitorë të cilët vijnë për pushime në hapësirat përgjatë tij, ku në shumicën e rasteve manifestohet edhe me krijimin e problemeve të caktuara mjedisore. Ky liqe dhe hapësira përrreth tij është propozuar të shpallet edhe park nacional.




Foto 1. Liqeni i Batllavës

KARAKTERISTIKAT DEMOGRAFIKE

a) Popullsia

Sipas regjistrimit të vitit 1981 Komuna e Podujevës kishte 127.376 banorë, me regjistrimin e vitit 2011 janë evidentuar 88,499 banorë, që nënkupton se 38.000 banorë ose 30% më pak se vitin 1981 .

Shumica e popullsisë (64.5 %) jeton në fshat, ndërsa 35.5 % e saj jeton në qytet, respektivisht në qendrën e vetme, që është Podujeva.

Dendësia mesatare e banimit në nivel të komunës arrin në 139 banorë në një km^2 , kurse në vendbanimet rurale është 130.7 banorë në km^2 . Hapësirat me dendësi më të madhe janë rrëth qendrës komunale dhe në zonën e rrafshët, ku dendësia e banimit arrin mbi 500 banorë në km^2 dhe kështu tejkalon mesataren e dendësisë së hapësirës së komunës.

KOMUNA E PODUJEVËS	PËRKATËSIA ETNIKE/KULTURORE										GJITHSEJ
	SH	S	T	B	R	A	E	TË TJERË	PREFERON MOS TË PËRGJIGJET	NUK KA TË DHËNA PËRKATËSIE	
	87,523	12	5	33	74	680	2	43	7	120	88,499

Tabela 5. Popullsia sipas përkatësisë etnike/kulturore në Komunës së Podujevës(të dhëna nga Agjensia e Statistikave të Kosovës)

KOMUNA E PODUJEVËS	STRUKTURA GJINORE		
	FEMRA	MESHKUJ	GJITHSEJ
	43,544	44,955	88,499

Tabela 6. Struktura gjinore e popullsisë në Komunës së Podujevës(të dhëna nga Agjensia e Statistikave të Kosovës)

MOSHA	KOMUNA E PODUJEVËS
(0-4)	8,473
(5-9)	9,287
(10-14)	9,048
(15-19)	8,499
(20-24)	8,277
(25-29)	7,535
(30-34)	7,009
(35-39)	6,323
(40-44)	5,086
(45-49)	4,352
(50-54)	3,810
(55-59)	3,041
(60-64)	2,694
(65-69)	2,038
(70-74)	1,464
(75-79)	951
80+	612
TOTALI	88,499




Tabela 7. Popullsia sipas grupmoshave në K. e Podujevës (*Të dhëna nga Agjensia e Statistikave të Kosovës- Doc. VJETARI STATISTIKOR I RE. SË KOSOVËS 2017*)

JETËGJATËSIA

KOMUNA E PODUJEVËS	MOSHA MESATARE E VDEKJEVE NË K. E PODUJEVËS		
	FEMRA	MESHKUJ	MESATARJA
	68.9	69.8	69.5

Tab. 8 . Mosha mesatare e të vdekurve në Komunës së Podujevës(*Të dhëna nga Agjensia e Statistikave të Kosovës- Doc. STATISTIKAT E VDEKJEVE 2016*)

a) Vendbanimet

Pjesa më e madhe e objekteve të banimit i takon karakterit individual, ndërsa në qendër urbane janë një numër i vogël i objekteve banesore që i takon karakterit kolektiv. Numri i përgjithshëm i objekteve të banimit në kuadër të komunës së Podujevës është 12315, nga të cilat, 7891 objekte ose 64.1 % janë të ndërtuara në zonat rurale, ndërsa 4424 objekte të banimit, ose 35.9 % e tyre janë të ndërtuara në zonën urbane. Objektet e vjetra të banimit janë të pakta se pse materiali i dobët i tyre nuk ka mundur t'i rezistojë kohës. Tani objektet e banimit ndërtohen me një e më shumë kate, kulmet me dy ujëra, ndërsa material ndërtimor janë: produktet e argjilës, betoni, çeliku, etj. Objektet e banimit në fshatra, fare pak dallojnë me ato në qytet. Kujdes i veçantë duhet ti kushtohet ruajtjes së tokës bujqësore, aty ku ato vendbanime janë me sipërfaqet produktive, pastaj zhvillimit të infrastrukturës dhe aktiviteteve tjera. Për minimizimin e konfliktit në mes tokave bujqësore dhe sipërfaqeve të ndërtuara dhe atyre në zhvillim, vendbanimet do të zhvillohen brenda kufirit të zonës së ndërtuar. Ruajtja e tokave bujqësore është një ndër kushtet /kërkuesat kryesore në ndërtimin/hartimin e Hartës Zonale.

SHFRYTËZIMI I TOKËS NË ha

Hapësirat	ha	%
Pyje	29,680.8	47.21
Bujqësia	18,764.8	29.85
Vendbanime	2,589	4.12
Varreza	77.33	0.12
Livadhe	3526	5.61
Kullosa	7,293.8	11.60
Mbeturina	61.6	0.10
Hapësira të lira	80.06	0.13
Degradim	47.05	0.07
Liqe	257.50	0.41
Lumej	77	0.12
Rrugë	451.48	0.71
Gjithsej	62870.8	100.00

Nga 62.870.8 ha tokë, vetëm 2,589 ha ose 4.12% është vendbanime dhe kjo signalizon se në shfrytëzim të tokë duhet të ketë racionalitet.

Tabela 9. Shfrytëzimi i tokës (ha)

VENDBANIMET NË KOMUNËN E PODUJEVËS DHE NR. I POPULLSISË NË ATO VENDBANIME

Nr.	Vendbanimi	Gj	Sh	S	R	A	E	Tjera
1	Bajçinë	2,358	2,351					7
2	Balloc	2,131	2115					16
3	Barainë	98	98					
4	Batllavë	2334	2286			43		5
5	Bellopojë	1,412	1,411					1
6	Bervenik	72	72					
7	Bllatë	9	9					
8	Bradash	2567	2561				1	5
9	Brainë	268	268					
10	Brecë	119	118					1
11	Buricë	246	246					
12	Dobërdol	1106	1104	1				1
13	Dobratin	1576	1571					5
14	Dumnicë e ep.	497	496					1
15	Dumnicë e po.	2,975	2,972					3
16	Dumosh	1,207	1,207					
17	Dvorishtë	143	143					
18	Dyz	573	573					
19	Gërdoc	1263	1261					2
20	Gllamnik	3794	3791					3

21	Godishnjak	353	350					3
22	Halabak	623	623					
23	Herticë	741	738					3
24	Kaçibeg	494	494					
25	Kalaticë	89	88					1
26	Kerpimeh	755	755					
27	Kushevicë	204	204					
28	Kunushec	873	871					2
29	Letanc	2,080	2,076					4
30	Lividicë	296	296					
31	Lladoc	821	821					
32	Llapash.e Ep.	2,363	2,360					3
33	Llapash.e Po.	2,701	2,700					1
34	Llaushë	980	976					4
35	Llugë	1,404	1,403					1
36	Lluzhan	757	756					1
37	Lupç i Epërm	275	274					1
38	Lupç i Posh.	2,113	2,111					2
39	Majac	1,622	1,621					1
40	Merdare	188	187					1
41	Metehi	1,251	1,243					8
42	Metergoc	79	71	7				1
43	Mirofc	132	132					
44	Muhazob	---	----					-

45	Murgullë	135	134					1
46	Obrançë	3,092	3,086					6
47	Orllan	844	803			2	33	6
48	Paka.e Ep.	732	732					
49	Paka. e Po.	292	292					
50	Penuhë	539	538				1	
51	Peran	1,241	1,238					3
52	Perpellac	---	----					
53	Podujevë	23,453	22,696	3	74	604		76
54	Pollatë	239	239					
55	Popovë	181	181					
56	Potok	61	61					
57	Radujevc	----	-----	-				
58	Rakinicë	14	14					
59	Recicë	-----	-----					
60	Repë	484	483				1	
61	Revuq	924	923				1	
62	Sallabajë	506	505				1	
63	Sfeçel	1,739	1,735				4	
64	Shajkoc	1,504	1,500				4	
65	Shakovicë	619	617				2	
66	Shtedim	1,148	1,140				8	
67	Siboc i Ep.	961	959				2	
68	Siboc i Posh.	454	454					

69	Sllatinë	130	130				
70	Surdull	27	27				
71	Surkish	1,091	1,091				
72	Sylevicë	63	63				
73	Terrnavë	853	853				
74	Terrnavicë	27	27				
75	Turuçicë	109	109				
76	Velikarekë	544	544				
77	Zakut	453	448				5
78	Zhiti	98	98				

Tabela 10. Vendbanimet dhe nr.i popullsisë në vendbanimeve përkatës

KOMUNA		Podujevë	
Nr.i popullsisë		88,499	
Zona rurale		77	
Zonat urbane		1	
Nr. fshatrave/Nr. i lagjeve		77	
Banimi individual	Nr.i objekteve para 1999	16,863	
	Nr. Objekteve pas 1999	18,723	
	Etazhiteti mesatar	P+1	
Banimi kolektiv	Para 1999	Nr. objekteve	13
		Nj.banimi	162
	Pas 1999	Nr. objekteve	3
		Nj. Banimi	37
	Etazhiteti mesatar		P+4
Statusi pronësor (banim kolektiv)para 1999	Privat (nj.banimi)	ska	
	Shoqëror (nj.banimi)	162	
Raport banimi individual/ banim kolektiv (%)		8.9%	
Kyqjet në infrastrukturë të objektve të banimit (%)		80%	
Nr. i objekteve të pabantuara		ska	
Nr. i objekteve me vlerë kulturo-historike që shfrytezohen për banim		ska	
Aplikimi i masave termo-izoluese në objektet e banimit (%).		25%	

Ndërtimet ilegale	Ndërtime		ska
	Ndërtime tjera		ska
Ndërtimet në pronë shoqërore		1	
Numri i kërkesave për zgjedhjen e qështjes së banimit		52	
Lokacionet (siperfaqja e tokës) për programet e veçanta të banimit		1.85,99 ha	
Nr. i objekteve /Nj. Banimi e ndërtuara nga Komuna,Qeveria dhe Donatore		70	
Nr. i objekteve /nj.banimi me qira nga dhe vlera mes.e qirasë		ska	
Nr. i objekteve/ nj.banimi të disponueshem për qira të ulëta të tregut		ska	
Nr. i objekteve /nj. Banimi në pronësi te Komunës që mund të adaptohen		ska	
Qendrat e përkohshme kolektive (QPK)	Numri i QPK		1
	Vendndodhja / emertimi		Balloc
	Nr. i familjeve		132
	Nr. i banorëve		529
Planet rregulluese- sa janë bërë dhe sa janë që duhet të bëhen		2+ Zonale	Harta

Tabela 11. Gjendja faktike

AMBENTI BIZNESOR

Ambienti biznesor është i përshtatshëm në komunën tonë sepse prej 2010 është hapur Qendra e Regjistrimit të Biznesit dhe janë lehtesar shumë procedura administrative për regjistrimin e biznesit. Deri më tani janë të regjistruar 4,600 biznese (edhe pse një numër i madh i tyre nuk funksionojnë por në regjistrat tonë ende figurojnë si biznese).

Obligimet ndaj Komunës:

Bizneset e reja të regjistruar janë të liruar nga Tarifa Komunale për atë vit të cilin bëhet regjistrimi si dhe vitin e ardhshëm, ndërsa për bizneset pronarët e të cilave janë femra, lirohen për vitin e regjistrimit dhe 2 vitet e ardhshme. Po ashtu bizneset bujqësore janë të liruar për atë vit dhe 3 vitet e ardhshme.

Nga viti 2018 ka hyrë në fuqi rregullorja e re ku është bërë zbritje 50% të tarifës për të gjitha bizneset. Të gjitha këto janë bërë me qëllim të lehtësimit të veprimit biznesor dhe krijimit të një klime sa më të volitshme biznesore.

KORNIZA E SHPENZIMEVE-POTENCIALI I KOMUNËS BUXHETI

NR.		2017	2018	2019	2020
1	Granti i përgjithshëm	6,351,725.00	7,635,865.00	8,310,705.00	9,055,133.00
2	Granti për arsim	8,933,4434.00	8,753,733.00	9,244,550.00	9,287,412.00
3	Huamarrja në arsim	0.00	32,779.00	21,819.00	0.00
4	Granti për shëndetësi	2,191,818.00	2,685,138.00	2,654,970.00	2,787,719.00
6	Gjithsej HVK (të hyrat vetanake komunale)	1,847,800.00	1,557,614.00	1,598,175.00	1,642,540.00
	Gjithsej	19,324,786.00	20,671,129.00	21,830,219.00	22,772,804.00

Tabela 12. Skema buxhetore sipas grandeve dhe THV-Komunale

PLANIFIKIMI HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURA

Nr.	ZONAT E MBULUARA ME PLANE URBANE	SIPERFAQJA E KOMUNËS SË PODUJEVËS (ha/vendbanime)	SIPËRFAQJA E ZONËS ME PU	PËRQINDJA
1	PLANI DETAJ URBAN "PODUJEVA 2"	63,259.97 ha	154.68 ha	0.25%
	PLANI RREGULLUES URBAN "ZONA QENDËR" PODUJEVË		30.00 ha	0.05%
2	VENDBANIMET	77 Vendbanime	/	/

Tabela 13. Sipërfaqja e përfshirë në plane urbane

Me përfundimin e hartimit të Hartës Zonale të Komunës së Podujevës si obligim ligjor, ne do të kemi të definuara rregullat e shfrytësimit të tokës-parametrat urban, zonat ekonomike, zonat e banimit, etj. Hartimi i Hartës Zonale të Komunës së Podujevës është duke u zhvilluar në bashkpunim me Organizatën Gjermane "GIZ" dhe pritet të përfundoj në vitin 2019. Harta Zonale si bazë ka PZHKG dhe PZHU.

ANALIZË E GJENDJES EKZISTUESE TË BANIMIT SOCIAL

Në vijim do të prezantohet gjendja aktuale lidhur me objektet në pronësi të komunës të dedikuara për banim social si dhe numri/profil i familjeve tani më të ndihmuara me sigurim të banimit. Po ashtu do të prezantohet kërkesa aktuale për banim në Komunën e Podujevës.

OBJEKTET KOMUNALE TË DEDIKUARA PËR BANIM SOCIAL

Komuna e Podujevës ka ndarë parcelën dhe ka rregulluar infrastrukturen (rrjetin e ujësjellisit, kanalizimit, kyqjen në rrjetin energetik) në Lagjen e Dëshmorëve për ndërtimin e 132 shëpive për shfrytëzim nga familjet (familje të dëshmorëve, invalidë të luftës, familje me fëmijë jetim, familje në skemë sociale) të cilat kanë qenë të vendosura në kontinjerë në atë lokacion. Deri tani, në bashkëpunim me MPMS, janë ndërtuar 70 shtëpi (2013-2018). Nëpër shtëpi (55m², shtëpi përdhesë, me oborr) janë vendosur 50 familje, ndërsa 20 familje tjera presin që të vendosen. Pjesa e familjeve të mbeturat jetojnë ende në kontinjera. Bazë e përzgjedhjes së përfituesve ishte Ligji mbi financimin e programeve të veçanta të banimit dhe Rregullorja e Kuvendit Komunal për këtë qëllim.

Komuna ka ndërtuar nga 10 shtëpi për vit për familjet raste sociale nga viti 2009-2014. Këto shtëpi kryesisht janë ndërtuar nëpër prona individuale të këtyre familjeve.

Më poshtë janë të përshkruara objektet në të cilat janë të vendosura familjet në nevojë për banim social .




Fig. 4 Lagja e Dëshmorëve



Foto 2 Shtëpitë sociale në Lagjen e Dëshmorëve

STRUKTURA E 50 FAMILJEVE TË CILAT DERI TANI KANË PËRFITUAR SHTËPITË NË LAGJEN E DËSHMORËVE:

1	Familje të dëshmorve	17
2	Veteranë të luftës	10
3	Invalidë të luftës	7
4	Viktima civile të luftës	14
6	Me asistencë sociale	22
	Gjithsejt	70

SKEMA E PËRFITUESËVE TË ASISTENCËS SOCIALE

NUMRI I FAMILJEVE	1037
NUMRI I ANËTARËVE TË FAMIJEVE	4841
SKEMA E PËRFITUESËVE NGA MOSHA (0-18)	138
SKEMA E PËRFITUESËVE TË FAMILIEVE TË DËSHMORËVE DHE INVALIDËVE TË LUFTË	873

Tabela 14 Skema Sociale

Objektet tjera pronë publike në të cilat janë të vendosura familjet qështja e pronësisë të së cilave është ende e pazgjidhur janë:

Në objektin banesor afër stacionit hekurudhor në mënyrë jo ligjore janë të vendosura 22 familje.



Foto 3 Objekti banesor Rr., „Hekurudha”




Foto 4 Objekti në rrugën “Hyzri Talla”(në të cilën jetojnë 5-pesë familje)



Foto 5 Objekti në rrugën “Hyzri Talla”(në të cilën jetojnë 5-pesë familje)



Foto 6 Objekti në rrugën "Nuhi Gashi" (Ku jetojnë 5-pesë familje)




Foto 7 Objekti në rrugën "Nuhi Gashi" (Ku jetojnë 5-pesë familje)

KATEGORITË E SYNUARA

Sipas Ligjit për Programet e Veçanta të banimit sigurimi i banimit bëhet përmes financimit të programeve të veçanta të banimit me qira, ku përfshihen:

- 1.1. Banesat e ndërtuara nga Komuna, Qeveria dhe donatorët të cilat jepen me qira;
- 1.2. Banesat ekzistuese në pronësi të personave fizikë apo juridikë, të cilat mundtë jepen me qira për familjet që posedojnë bonus të banimit;
- 1.3. Banesat tjera në pronësi të komunës, që mund të adaptohen për shfrytëzim në bazë të programeve të veçanta për banim.

Kategoritë e familjeve që mund të përfitojnë nga programet e veçanta të banimit

1. Kategoritë e familjeve që mund të përfitojnë nga programet e veçanta për Banimpërfshijnë familjet që:

- 1.1. Nuk kanë banesë apo shtëpi në pronësi individuale;
 - 1.2. Kanë mbetur pa banesë-shtëpi, si rezultat i dëmtimit të shtëpive gjatë luftës së fundit në Kosovë,
 - 1.3. Posedojnë sipërfaqe banimi nën normat e banimit, të përcaktuara për atë kategori sociale dhe ekonomike.
2. Administrimi i kërkesave për programet e veçanta për banim bëhet nga organi kompetent komunal.
3. Normat e banimit sipas nën-paragrafit 1.3. të paragrafit 1. të këtij nenit, Përcaktohen me Udhëzim Administrativ

Përparësi në përzgjedhjen e përfituesve për subvencionim të qirasë kanë:

- 1.1. Familjet me shumë fëmijë;
- 1.2. Familjet që në përbërjen e tyre kanë persona me aftësi tëkufizuara;
- 1.3. Familjet ku kryefamiljari është grua-mbajtëse efamiljes;
- 1.4. Bashkëshorti ose bashkëshortja e shkurorëzuar që ka në përkujdesje fëmijë;
- 1.5. Fëmijët me statusin e jetimit.

KRITERET PËR PËRCAKTIMIN E RADHËS SËPËRPARËSISË

Në pajtim me dispozitat e Ligjit për financimin e programeve të veçantëa të banimit kriteret e përparësisë për sigurimin e banimit për kategoritë e cekura në pikën 7.1 janë:

- Statusi i banimit;
- Lartësia e të ardhurave
- Gjendja shëndetësore
- Invaliditeti
- Struktura e familjes

Sipas Ligji për Financimin e Programeve të Veçanta të Banimit Nr. 03/L-164 nga fq.30-32

Sipas, Udhëzimi Administrativë Nr. 21/2010 për Përcaktimin e Radhës së Përparësisë për Kategoritë e Familjeve që mund të përfitojnë nga Programet e Veçanta të Banimit janë 25kriteret bazë të cilave familjet mund të përfitojnë banimin social, e ato janë si mëposhtë:

Shtoja Nr. 1. Kriteret sipas radhës së përparësisë

Nr.	TABELA E VLERËSIMIT SIPAS KRITERËVE TË PËRPARËSISË		Pikët
I	STATUSI I BANIMIT	1.1 Familjet që jetojnë në objekte të rrëzishme ose të papërshtatshme për banim.	10
		1.2 Familjet që jetojnë në objekte që janë nën normat minimale të banimit.	8
		1.3 Familjet që Jetojnë në objekte të buaja.	6
		1.4 Familje që jetojnë me qira të tregut për më shumë se 5 vjet.	4
II	LARTËSIA E TË ARDHURAVE	2.1 Familjet me të ardhura mbi kufirin minimal deri në 150 Euro.	10
		2.2 Familjet me të ardhura nga 150 - 250 Euro.	8
		2.3 Familjet me të ardhura nga 250 - 300 Euro.	6
		2.4 Familjet nën kufirin minimal të të ardhurave të përcaktuara sipas nenit 6, të Ligjit, që subvencionohen nga komuna.	10
III	GUENDJA SHËNDETËSORË	3.1 Familjet me përkujdesje të personave, fëmijëve me çregullime të përherësime shëndetësore.	8
		Sëmundje të rëndë kronike konsiderohen: sëmundjet malinje, sëmundjet e rënda të gjakut, diabeti tek rastet e rënda me insulinë, sëmundjet e ndryshme kronike të veshkave në dialezë dhe pas transplantave të veshkës, forma të rënda të astmës, sëmundjet kronike të papërcaktuara të mushkërive, tuberkulozi, sklerozë, sëmundjet e sistemit imunitar, format e rënda të çregullimeve të metabolizmit, epilepsia, sëmundjet tjera të rënda të zemrës dhe neurozat.	6
IV	INVALIDITETI	4.1 Invalid me mbi 80% të dëmtimit trupor, të cilëve përfjetë normale n' nevojitet përkujdesja dhe ndilima e një personi tjeter.	10
		4.2 Invalid me 71% deri 80% të dëmtimit trupor.	9
		4.3 Invalid me 61% deri 70% të dëmtimit trupor.	8
		4.4 Invalid me 51% deri 60% të dëmtimit trupor.	7
		4.5 Invalid me 41% deri 50% të dëmtimit trupor.	6
		4.6 Invalid me 31% deri 40% të dëmtimit trupor.	5
		4.7 Invalid me 21% deri 30% të dëmtimit trupor.	4
		4.8 Invalid me 10%deri 20% të dëmtimit trupor.	3
V	STRUKTURA E FAMILIES	5.1 Të moshës 0-5 vjet që kanë nevojë për përkujdesje të plotë.	8
		5.2 Ndërmjet moshës 6 - 18 vjeçare, që janë në shkollim.	6
		5.3 Ndërmjet moshës 18 - 25 vjeçare, që janë në shkollim.	4
		5.4 Të moshës mbi 65 vjeçare.	3
VI	KRITERET SHËSE	6.1 Familje dëshmorë.	10
		6.2 Familje e kryesuar nga një prind.	9
		6.3 Familje në përkujdesje të fëmijëve jetim.	8
Gjithsej:			

¹ Familjet me të ardhura nën kufirin minimal të përcaktuara sipas nenit 6 të Ligjit vetëm në rastet kur komuna subvencionon qiranë joprofitabile sipas paragrafit 3 të nenit 7 të këtij Udhëzimi administrativ.

KËRKESAT FAKTIKE PËR PËRKRAHJE

Në tabelë perfshihen familjet të cilat kanë kërkuar ndihmë nga komuna për ndërtim të shtëpisë

Viti	Kërkесат zyrtare	Rastet e vizituara në bazë të kërkесave nga përfaqësuesit e fshatrave apo palëve të treta	Rastet e identifikuar a të nevojave për banim	Të ndërtuara nga donatorët	Familjet në Lagje të Dëshmorve(në kontinjerë)	Ndërtimet e shtepive në Lagje te Dëshmorve- projekt nga Ministria ne bashkëpunim me Komunën
2015	9	35	/	6	132	50
2016	12	38	16	15	62	0
2017	15	81	20	10	62	10
Nëntor 2018	38	52	29	13	62	10

Tabel 16 Gjendja aktuale, kërkесat dhe analizat

PLANIFIKIMI KONKRET PËR NDIHMË PËR BANIM SOCIAL

Programi për banim për të gjithë i Komunës së Podujevës është hartuar për periudhën 2019-2021. Komisioni i formuar nga ana e Kryetarit të Komunës me ndihmën e OJQ Developing Together ka bërë analizë të gjendjes ekzistuese dhe ka përgatitur propozime konkrete për të ndihmuar qytetarët e Komunës së Podujevës që nuk kanë mundësi të sigurojnë kulm mbi kokë. Përpos ndihmës konkrete për qytetarët e vet, brenda kësaj periudhe tre-vjeçare do të vazhdohet me analiza për të krijuar sektorin e banimit në kuadër të komunës së Podujevës i cili i mungon komunës sonë.

Pra, Programi i prezantuar Tre-Vjeçar për Banim i ka dy objektiva:

O1. Sigurimin e banimit deri në 120 familje;

O2. Formimin e sektorit për banim;

01. SIGURIMI I BANIMIT DERI NË 40 FAMILJE

Prioritet kryesor i këtij programi është që në periudhën tre vjeçare komuna e Podujevës të jetë në gjendje të ndihmojë 90-100 familje duke ju siguruar Banim Social.

Kjo do të bëhet në përputhje të plotë me Ligjin për Financimin e Programeve Tre-Vjeçare për Banim. Sipas këtij ligji, sigurimi i banimit bëhet përmes financimit të programeve të veçanta të banimit me qira, ku përfshihen:

- a) banesat e ndërtuara nga Komuna, Qeveria dhe donatorët të cilat jepen me qira;
- b) banesat ekzistuese në pronësi të personave fizikë apo juridikë, të cilat mund të jepen me qira për familjet që posedojnë bonus të banimit;
- c). banesat tjera në pronësi të komunës, që mund të adaptohen për shfrytëzim në bazë të programeve të veçanta për banim.

BANESAT E NDËRTUARA NGA KOMUNA, QEVERIA DHE DONATORËT TË CILAT JEPEN ME QIRA;

Komuna e Podujevës për momentin nuk ka banesa të ndërtuara nga Komuna, Qeveria dhe Donatorët të cilat jepen me qira, por planifikohet që shtëpitë e ndërtuara ne Lagje të Dëshmorëve, të ju caktohet një vlerë e qirasë për shfrytëzimin e tyre.

Planifikimi në tre vitet e ardhshme

Komuna e Podujevës do të vazhdoj bashkëpunimin me MPMS për finalizimin e ndertimit të shtëpive të planikuara ne Lagjen e Dëshmorve si dhe komunikimin me donatorë të ndryshëm të cilët janë të interesuar të ndihmojnë familjet të cilat kanë nevojë për banim që të ju ndërtohen/rinovohen shtëpi individuale. Kjo është forma më e qëndrueshme për të siguruar banimin për këto familje.

Komuna e Podujevës do të ofrojë informatat relevante dhe do të inicojë programe në këtë drejtim.

PLANIFIKIMI BUXHETOR PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT

Për realizimin e Programit Tre-Vjeçar për Banim në Komunën e Podujevës duhet që të bëhet planifikim buxhetor në bazë vjetore. Siç është cekur më lartë, përmes këtij programi komuna e Podujevës planifikon të ndihmojë familjet të cilat nuk janë në gjendje që me financim vetanak të sigurojnë banimin.

Nga Komuna e Podujevës kërcohet që për nevoja të këtij programi në periudhën 2019-2021 të siguron buxhetin. Në formë tabelore kjo ndarje duket si në vijim:

Mënyra e ndihmës	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021	Totali
Ndërtimi i banimit social për strehimin e familjeve. Ndërtimi i objekteve individuale/ shtëpi për familjet raste sociale	183.270,00	100.000,00	100.000,00	383.270,00

Tabela 17: Buxheti i planifikuar për banim social për vitet 2019-2021

Duhet cekur se përpos buxhetit të lartë përmendur të zotuar nga vetë komuna e Podujevës, do të kërcohet ndihmë nga donatorë të tjerë përfshirë qeverinë e Kosovës dhe donatorë të jashtëm.

ANALIZA E FAKTEVE – PËRMBLEDHJE

1.	Qëllimi i hartimit të programit tre vjeçare	Qëllimi kryesor i përpilimit të Programit Tre-Vjeçar në Komunën e Podujevës është që të ndihmohen familjet të cilat kanë nevojë për banim social e nuk kanë mundësi vetanake për të siguruar strehë mbi kokë.
2.	Baza ligjore	Ky program bazohet në legjislaturen ekzistuese të Republikës së Kosovës të përshkruar më detajisht në kapitujt e sipërm të këtij dokumenti. Sidoqoftë dy dokumentet kryesore janë Ligji për Financimin e Programeve të Veçanta për Banim (03/L – 164) dhe Udhëzuesin për Hartimin e Programeve Tre-Vjeçare për Banim. Ky program mundëson një lidhje organike midis mandatit 4 vjeçar te pushtetit lokal dhe projekteve komunale ne fushën e banimit. Është i paraparë afati 3vjecar, te jete me i përshtatshëm për të hartuar dhe për të dhëne në jetë programet e banimit, duke marre parasysh veçoritë e Komunës së Podujevës si p.sh: politikat komunale te banimit (si vecorit perkatese), pozita gjeografike, demografike dhe institucionale.
3.	Llojet e programeve të konsideruara si të nevojshme	Vazhdimi i ndërtimit të shtëpive për familjet të cilat nuk munden të bëjnë vet financimin dhe ndërtimin e shtëpisë.
4.	Prezantimi i gjendjes faktike	Aktualisht kemi kërkesa të vazhdueshme për ndërtim te shtëpive nga familjet raste sociale.
5.	Kërkesat faktike për përkrahje me sigurim të banimit	<ul style="list-style-type: none"> A) Familjet qe nuk kanë banesë apo shtëpi B) Familjet qe nuk posedojnë sipërfaqe banimi C) Familjet qe janë me kategori sociale, nenat vetushqyese D) Te riatdhesuarit, kategorit e dala nga lufta dhe komunitete.

6.	Klasifikimi i nevojave sipas urgjencës se trajtimeve te tyre	Sipas kriterieve do te percaktohen mbas ligjit nr. 03/L - 164, mbas komisionit te caktuar nga kryetari i komunes. Shpresojmë që edhe softueri për regjistrimin e përfituesve do të ndihmon shumë në këtë drejtim.
7.	Veprimet kryesore që do të ndërmerren	<ul style="list-style-type: none"> • Regjistrimi i aplikuesve; • Vendosja e tyre në Data Bazë; • Vizita në terren; • Krijimi i listës prioritare për ndihmë sipas mundësive buxhetore; • Nenshkrimi i kontratës me përfitues të banimit social; • Mirëmbajtja e ndërtueseve në bashkëpronësi të dedikuara për Banim Social;
8.	Kohëzgjatja e realizimit të programeve	2019-2021
9.	Kornizën e shpenzimeve afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjate	Të bëhet ndarja e mjeteve për ndertim, rinvim të shtepive, në bazë të kërkuesave të qytetarëve, ku komisioni do të bëjë vlerësimin dhe përzghedhjen e familjeve përfituese.
10.	Mundësítë e kapaciteteve njerëzore dhere materiale	Planifikimi i buxhetit Donatorët Zyrtari i banimit

11.	Mënyra financimit e programeve vjeçare plotësohet me dokumentin programet trevjeçare banimit)	e te (të më në me të	Buxheti komunal Niveli qendoror-MMPH,MPB,MPMS,MKK Donatorët
12.	Përputhja e programeve me planet zhvillimore të komunës	e	PZHK dhe PZHU i miratuar ku janë definuar zonat e banimit
13.	Instrumentet mbikëqyrëse	e	Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mjedis Zyra e Kryetarit Zyrtari për banim (duhet caktuar një zyrtar)
14.	Instrumentet e garantimit të realizimit të programeve	e te	Monitorimin,raportet vendimet e e Kuvendit Komunal dhe programet e ndryshme të caktuara.
15.	Transparenca me hartimin dhe zbatimin e programeve	e	Analizë,debate publike me ekspert të ndryshëm, raportet etj.

INSTRUMENTET MBIKQYRËSE

Themelimi i Sektorit të Banimit brenda Komunës së Podujevës i cili do të jetë përgjegjës për të gjitha aktivitetet e planifikuara mundëson që komuna të ketë mbikqyrje direkte në zbatimin e Projekteve të Banimit. Ky sektor do të raportoj pranë Asamblesë Komunale çdo gjashtë muaj. Po ashtu edhe Ligji e parashevë që MMPH të mbikëqyrë zbatimin përmes inspektorëve të urbanizmit.

TRANSPARENCA DHE PËRFSHIRJA E PUBLIKUT

Publiku si sovrahi i Komunës, ka të drejtën të dijë mënyrën sesi shpenzohen të ardhurat e komunës në tërësi dhe ato të programeve tre vjeçare në veçanti, këto të dhëna do t'i sigurohet duke përfshirë publikun në procesin e sigurimit të transparencës si:

- zhvillimin e takimeve konsultuese mepublikun;
- bërja e anketimeve apo studimeve të ndryshme për marrjen e mendimit tëpublikut;
- bërjen publike të programeve dhe projekteve që përfshijnëato
- sigurimit të pjesëmarrjes së publikut gjatë diskutimeve që organet përkatëse do të zhvillojnë për hartimin, miratimin dhe zbatimin eprogrameve;
- bërjen e njoftimeve të ndryshme në mjetet e informimit publik apo në vendnjoftimet komunale për aktivitetet ku mund të sigurohet pjesëmarrja e publikut
- çdo masë tjeter e cila vlerësohet e nevojshme në përbushje të këtij qëllimi

02 THEMELIMI I SEKTORIT TË BANIMIT

Programi për Banim i Komunës së Podujevës mbulon periudhën 2018 - 2020. Komisioni ka përgatitur propozimet për projekte prioritare zbatimi i të cilave rezulton ne arritjen e synimeve zhvillimore të përcaktuara në fushat kyçe, detyrimet, aktivitetet, bartësit kryesor, afatin kohor te implementimit, përgatitjes dhe koordinimit të aktiviteteve të përgjithshme për implementimin e projekteve. Në mënyrë që të sigurojë zbatimin e projekteve të planifikuara do të shqyrtohet mundësia për formimin e Sektorit të banimit i cili do të jetë përgjegjës për koordinimin e te gjitha aktiviteteve te planifikuara.

Sektori i banimit është një organ i përhershëm që do të formohet me qëllim të monitorimit dhe vlerësimit të zbatimit të projekteve dhe detyrave nga Programi i banimit, si rishikimin e Strategjisë dhe Planit te Veprimit dhe mbështetjen e Kryetarit te Komunës për marrjen e Vendimeve qe lidhen me zhvillimin e banimit dhe programet lokale që mbështesin fushën e banimit.

Nga të dhënat e mësipërme , si prioritet mund të zhvillohet:

- Programi i ndërtimit të shtëpive sociale.

ÇËSHTJET E TJERA

Gjatë hartimit të programeve tre vjeçare janë marrë parasysh këto standarde

- Realizueshmëria
- Qëndrueshmëria
- Efektshmëria
- Mjaftueshmëria e kapaciteteve njerëzore dhemateriale
- Respektimi iligjit
- Barazia
- Ndikimi në mjedis dhe energjia e pastër
- Normat e banimit
- Ndërthurja e këtyre programeve me politikat qendrore tëbanimit
- Transparenca
- Standarde tjetra

SWOT ANALIZA

PËRPARËSITË	DOBËSITË
<ul style="list-style-type: none"> Ekzistimi i dokumenteve të planifikimit hapësinor Ekzistimi i iniciativave për PPP në fushën e ndërtimeve-banimit Infrastruktura në zonat urbane Subjektetekonomikeshfrytëzues Nevoja për zona të reja tëbanimit Ekzistimi i zonave të planifikuara përbanim Ligjet nga fusha ebanimit Burimet njerëzore, autoritetet komunale të përkushtuara për kategoritë errezikuara Rexhistrimi ipopullsisë Të dhënat përkërkuesit Mbulueshmëria me infrastrukturë Strategjitetekomunale Interesimi i qytetareve për pjesëmarrje në këto programe 	<ul style="list-style-type: none"> Parcela të vogla Oferta dhe kërkesa jo të harmonizuara Kosto e larte e pajisjes me inf. adekuate Kosto e larte e banimit dhe kualiteti i ndërtimit jo adekuat Kapacitete jo te mjaftueshme komunale për zhvillimin e banimitsocial Nuk ka programe të mjaftueshme që ndërmerren për kategoritë ecaktuara Mungesa e interesimit të grupeve tjera për pjesëmarrje në ketë sidomos tërinje Pronësia e pa definuar ...AKP Mirëmbajtja e objekteve të banimit kolektiv jo e organizuar (jo ekompletuar). Mungesa e sektorit për banim pranë DSHMS
MUNDËSITË	RREZIQET
<ul style="list-style-type: none"> Ligjet dhe Programet komunale përbanim Strategjitetë shtetërore dhe qendrore Formimi i sektorit përbanim Skemat garantuese 	<ul style="list-style-type: none"> Problemet e vazhdueshme ekonomike dhe financiare, Mungesa e fondeve ne nivel lokal, Kontrolli jo i mjaftueshëm në fushën endërtimive,

<ul style="list-style-type: none"> • Stimulimet për grupet ecaktuara, • Programet në nivel qendror në mbështetje në nivel lokal nga fusha endërtimit/banimit. • Ligjet përkatëse të inkurajojnë zhvillimin e banimi (LigjiPPP) • Mbështetje për ndërtimet në pronësi private – procedurat përmirësimin etyre. • Programe mbështetëse nga partner kombëtarë dhe ndërkombe tarë në fushën ebanimit. 	<ul style="list-style-type: none"> • Trendi i rritjes së numrit të popullsisë në zonat urbane në raport me planet financiare dhe materiale në fushën e ndërtimit, • Papunësia dhe mungesa e punësimit, • Niveli i lartë i varfërisë, Fenomeni i largimit apo e ashtuquajtura "ikje e trurit", • Mungesa e fondeve në nivellokal, • Kontroll jo i mjaftueshëm nga fusha endërtimeve, • Vonesat si dhe procedurat ngaAKP.
--	---

PËRFUNDIMI

Nevoja për hartimin dhe zbatimi i efektshëm i Planit për banim sipas programeve të veçanta kërkon koordinimin e aktiviteteve të gjithë akterëve në kuadër të komunës, në përputhje me kompetencat e përcaktuara.

Në këtë drejtim është i nevojshëm formimi i Sektorit për Banim si organi përgjegjës, që në mënyrë aktive të zhvillojë procesin e zbatimit të aktiviteteve sipas këtij Plani. Ndërtimi i njësive të reja të banimit sipas standardeve përmes fondeve nga buxheti komunal, Qeverisë dhe Partneriteti Publik - Privat, që do të siguroj banimin për grupe të caktuara.

Përmirësimi i kualitetit të banimit duke pasur parasysh objektet ekzistuese të banimit kolektiv që në një masë sektori i banimit do të ndikojë në ngritjen e vetëdijes dhe motivimin e pronarëve të njësive të banimit si domosdoshmëri e organizimit dhe menaxhimit.

BURIMI I TË DHËNAVE

1. Udhëzuesi për hartimin e programeve komunale trevejçare të banimit
2. Statuti i Komunës
3. PZHK dhe PZHU
4. Raportet e Agjensionit të Statistikave të Republikës së Kosovës